



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. Nr. 80/23 Dhe 84/23**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërjen Vjosa Gradinaj Mexhuani - Kryetare, Agon Ramadani- Referues, Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga operatori ekonomik OE "RUNWAY" SHPK. Prishtinë; GENC TAAHHUT GJYIM TEKSTIL INSAAT SAN.VE> TIC.LTD. STI VKN, me numër protokollit 80/23 dhe ankesën e parashtruar nga OE "SOLID" SH.P.K. Suharekë, me numër protokollit 84/23, kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit "Ritender- Furnizim me Çizme ushtarake për nevoja të FSK-së" me numër të prokurimit 217-22-7705-1-1-1, iniciuar Ministria e Mbrojtjes, në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK) me 02.05.2023, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet si e bazuar, ankesa e OE "SOLID" SH.P.K. Suharekë, e datës 13.02.2023 (Protokollit 84/23) dhe Anulohet Vendimi i autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit "Ritender- Furnizim me Çizme ushtarake për nevoja të FSK-së" me numër të prokurimit 217-22-7705-1-1-1, i komunikuar me njoftimin e datës 01.08.2022, kurse lënda kthehet në rivlerësim.
2. Hedhet e palejuar ankesa e OE "RUNWAY" SH.P.K. Prishtinë, GENC TAAHHUT GJYIM TEKSTIL INSAAT SAN.VE TIC.LTD. STI VKN, e datës 13.02.2023, (Protokollit 80/23).
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet të informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra me këtë aktivitet të prokurimit (i precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitiv të këtij vendimi) sepse OSHP është e detyruar të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse kërkohet dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emrin e tarifës ankimore, kurse ankuesit kanë të drejtë të paraqesin kërkesës për kthimin e mjeteve konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 01.08.2022, Ministria e Mbrojtjes, duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues, ka publikuar në faqen zyrtare të Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Ritender- Furnizim me Çizme ushtarake për nevoja të FSK-së” i evidentuar me numër prokurimi 217-22-7705-1-1-1.

Me 28.10.2022, AK (me të dhëna si më sipër) ka realizuar hapjen e ofertave kurse 27.01.2023, Ka publikuar njoftimin mbi vendimin e tij/sajë për dhënien e kontratës për OE të rekomanduar.

Me 01.02.2023, OE “RUNËAY” SH.P.K ka ushtruar kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila është refuzuar me Vendimin e AK, të datës 03.02.2023.

Me 01.02.2023, po ashtu dhe OE “Solid” SH.P.K. ka ushtruar kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila po ashtu është refuzuar me Vendimin e AK, po të datës 03.02.2023.

Me 13.02.2023, OE “RUNËAY” SH.P.K ka ushtruar ankesë në OSHP, kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila është regjistruar me numër protokollit 80/23.

Me të njëjtën datë, respektivisht me 13.02.2023, po ashtu dhe OE “Solid” SH.P.K. ka ushtruar ankesë në OSHP, kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila është regjistruar me numër protokollit 84/23.

*Me fazën e shqyrtimit paraprak,*

(a) Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesit ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bje nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

(b) Duke ju referuar ankesave të parashtruara, përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në raport me aktivitetin e prokurimit dhe aktin e atakuar të AK, konstatohet paraprakisht se lidhur me çështjen në rastin konkret, gjen zbatim aplikimi i nenit 84 (Bashkimi i çështjeve administrative në një procedure) i Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, lidhur me nenin 16 (Rastet e unifikuara) të Rregullores për Punën e OSHP, sipas të cilit Kryetari i OSHP ka të drejtë të vendos që ti bashkoj rastet/ankesat të cilat në kuptimin e pretendimeve ankimore janë

të lidhura me lëndën apo tenderin e njëjtë, mund të përfshihen në raportin e shqyrtimit fillestar nga i njëjti ekspert dhe përkitazi me to ka të drejtë të vendos i njëjti Panel shqyrtues.

(c) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me 08.03.2023, me rekomandimet si në vijim:

- Ankesat të aprovohen si të bazuara;
- Vendimi i AK për dhënie të kontratës të Anulohet dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim;

(d) Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se ankuesit janë pajtuar me mendimin e ekspertit, respektivisht me raportin e cituar, kurse AK është deklaruar se nuk pajtohet. Po ashtu konstatohet paraprakisht se palët janë në dijeni lidhur me të gjitha shkresat e kësaj lënde, në përbërjen kompletet të sajë sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj Paneli konsideron se ka kushte që të vendosi në mënyrë meritorë përkitazi me ankesat e ushtruara në rastin konkret.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Paneli konstatoi paraprakisht se nuk ekzistojnë elemente për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj mori në shqyrtim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë (mbajtur me 27.04.2023), sikurse parashihet me paragrafin 2, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Në këtë rast Paneli mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK, raportin e ekspertit dhe konstatoi se, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër:

- AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, kontratë me vlerë të madhe, vlera e parashikuar e kontratës 2,000,000.00 €, përderisa kriteri i dhënies ka qenë tenderi me çmimin më të ultë;
- Ankuesit kanë atakuar Vendimin më sipër të AK, për shkaqet dhe arsyet (përmbledhur) si në vijim të këtij arsytimi;

Ankuesi "RUNWAY" SH.P.K. i ka shprehur pretendimet ankimore gjithsejtë në shtatë paragraf të ankesës së parashtruar, nga të cilat mund të kuptohet i njëjti e ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK, kryesisht për faktin parimor se OE i rekomanduar për kontratë (sipas tij/sajë) nuk i plotëson kriteret për këtë aktivitet të prokurimit. Lidhur me këtë ankuesi ka shpjeguar se AK, e ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka dorëzuar atestet të cilat janë kërkuar në dosjen e tenderit (DT). Në vijim, ankuesi ka pohuar se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin

59 të LPP, pasi që nuk ka pasur të drejtë të kërkoj sqarime shtesë për specifikime teknike të cilat janë kërkuar në DT, duke ju referuar mes tjerash nenit 39.8, të RRUOPP sipas të cilit për specifikat teknike që nuk janë dorëzuar nuk mund të kërkojen sqarime shtesë, lidhur me nenin 59 të LPP. Në vijim, ankuesi ka pohuar se OE nuk ka ofruar foto të produktit (çizmeve) në katalogun e tij/sajë dhe të njëjtat nuk janë të pajisura me tiketën e origjinës ashtu siç ishte kërkuar në dosje të tenderit. Krahas pretendimeve të tija ankimore (të prezantuara shkurtimisht si më sipër), Ankuesi ka pohuar se i ka dorëzuar atestet, të cilat AK i ka kërkuar (ISO 20347) nga laboratorët e akredituar dhe si rrjedhojë, AK ka vepruar po ashtu në kundërshtim dhe me dispozitën e nenit 60 të LPP, me rastin e vlerësimit dhe ekzaminimit të tenderëve.

*Ankuesi "Solid" SH.P.K.* ka pohuar mes tjerash se OE i rekomanduar nuk e ka dorëzuar vërtetimin e gjykatës në emrin e kompanisë, respektivisht të entitetit afarist konkurrues por në emrin e subjektit fizik, duke shpjeguar dhe/ose supozuar se i njëjti (kompania) mund të jetë subjekt i ndonjë procedure të falimentimit. Në vijim ankuesi ka pohuar se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7.1 dhe 7.2, të FDT, meqë OE i rekomanduar i ka dorëzuar vetëm dokumentet e liderit, përderisa disa nga dokumentet tjera (përfshirë regjistrimi i firmës) janë dorëzuar në fund të aktivitetit e jo me rastin e dorëzimit të dosjes. Ankuesi më tej ka pohuar se OE i rekomanduar, i ka ofruar dokumentet lidhur me qarkullimin financiar në gjuhën turke dhe se një veprim i tillë konsiderohet të jetë në kundërshtim me FDT (neni 8.1 dhe 8.2. Kërkesat mbi gjendjen ekonomik dhe financiare) dhe me dispozitën e nenit 10 të LPP. Në vijim, Ankuesi ka shpjeguar se në kuptim të nenit 9.1. dhe 9.2. Kërkesat mbi mundësitë teknike, të FDT, AK ka kërkuar shprehimisht se, cituar: "OE duhet të paraqes tek autoriteti kontraktues të paktën nga një foto për secilin produkt..." Përderisa, OE i rekomanduar ka ofruar vetëm një foto të produktit në kundërshtim me kërkesat, me ç'rast AK është përgjigjur se, cituar "ngatërrimi i fotos duket qartë se ka qenë vetëm një gabim i vogël teknik i parëndësishëm". Krahas tjerash, ankuesi ka shpjeguar se AK ka kërkuar që atestet e kërkuara duhet të jenë nga laboratorët e akredituar ndërkombëtarisht sipas EN ISO të cilave nuk i është përmbajtur në këtë rast.

AK ne përgjigjen për rishqyrtim lidhur me pretendimin kryesor mbi bazën e të cilit është atakuar vendimi i saj vlerëson se katalogu ishte kërkuar që të bëhet i mundur vlerësimi i specifikimeve teknike të ofruara, OE ne katalog ka shënuar qartë emrin e produkteve dhe të gjitha specifikave te produkteve ashtu siç është kërkuar në DT, pasi që vlerësimi është bërë në bazë të mostrave të dorëzuara dhe këtyre specifikave të dhëna, *ngatërrimi i fotove duket qartë se është një gabim teknik dhe i parëndësishëm.* Duke i analizuar pretendimet ankimore të prezantuara shkurtimisht si më sipër, raportin e ekspertit shqyrtues, përfshirë po ashtu dhe të gjitha aktet e AK, Paneli vëren se në asnjë pike ne DT nuk është kërkuar që të dorëzohen atestet, mirëpo të njëjtat janë kërkuar gjatë rrjedhës së aktivitetit të prokurimit gjë që ky fakt vërtetohet me përgjigjen e AK të datës 28.09.2022, sipas të cilit është jo kontestuese se atestet e tilla vërtetë janë kërkuar dhe të njëjtat një rast të tillë padyshim se marrin tiparet e një kriteri.

Në aktet e AK (në pyetjet sqaruese) theksohet se është kërkuar që në katalog të shënohen specifikat teknike me vlerat e atesteve të përmendura por jo të dorëzohen atestet, sepse nuk janë kërkuar. Paneli konsideron se në kuptim të nenit 27 të LPP, parashihet se autoriteti kontraktues përpilon një dosje të tenderit me informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes. Në fakt, hartimi i DT i referohet pavarësisht së një AK që të njëjtën ta përpiloj në harmoni me nenin (8 Planifikimi i Prokurimit) dhe nenin 9 (Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur) të LPP, mirëpo nga pikëpamja e këtij Paneli një formulim i tillë nuk është në harmoni në parimet bazë të LPP. Në fakt DT konsiston në një dokument kyç në procesin e prokurimit publik dhe të njëjtës i referohet çdo palë e interesuar.

Në vështrim të përgjithshëm të shkresave të kësaj lënde, Paneli konsideron se mbetet jo kontestues fakti se, përkitazi me katalogun dhe/ose foton e produktit (si provë materiale) AK vërtetë ka deklaruar se, cituar: “ngatërrimi i fotove duket qartë se është një gabim teknik” mirëpo në këtë kontekst Paneli konsideron se AK nuk ka vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 59 të LPP, përderisa sipas paragrafit 1, të këtij neni parashihet fare qartë se, cituar: “autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës”. Mirëpo, nga pikëpamja e këtij Paneli për vazhdimin në aktivitetit të prokurimit në këtë rast, nuk mund të gjej zbatim paragrafi 1, dhe vlera e cituar 20% ngase produkti i kërkuar përbën vlerën totale të DT.

Më tej po sipas kësaj dispozite parashihet dhe/ose shpjegohet se, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar *kushtin material* apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në fakt, veprimet e AK gjatë rrjedhës së aktivitetit të prokurimit në këtë rast, nuk nënkuptojnë *devijime të vogla*, përderisa i terë ky aktivitet i prokurimit konsiston në një produkt të vetëm dhe se, çfarëdo gabim teknik nuk është parëndësishëm, sepse krijon efekt të drejtë për drejtë në kushtin material dhe objektivisht shkakton devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Prandaj bazuar në të lartcekurat dhe posaçërisht në natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, Paneli konsideron se rrjedha e mëtejme e procesit të prokurimit nuk është në pajtim me nenin 60 të LPP, sipas të cilit (paragrafi 2), cituar “Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do ti jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të *kritereve* dhe *peshës së tyre* përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 52 të këtij ligji. Kurse në nenin 52, të LPP, kërkohet shprehimisht nga AK, që sa më shumë që është e mundshme, autoriteti kontraktues duhet të *specifikojë çdo kriter* në mënyrë

objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre dhe se vetëm *kriteret e matshme* dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Bazuar në dispozitat e cituara nga njëra anë dhe duke u nisur nga çdo shikim i shkresave të kësaj lënde nga ana tjetër, konstatohet se produkti në rastin konkret, (çizmet) prezantojnë elementin me karakter qenësor të DT dhe përbejnë nevojë imanente për aktivitetin e prokurimit në rastin konkret. Prandaj produkti në rastin konkret determinon objektivisht këtë proces prokurimi sepse i njëjti ka të bëjë me kriterin kryesor dhe domethënës duke e nënkuptuar faktin se, ky produkt prezanton: *kriterin bazë të prokurimit, peshën kryesore të DT, specifikat*, e tjera, të cilat nga shkresat e kësaj lënde, sipas Panelit, nuk është vërtetuar se OE i rekomanduar i plotëson.

Kurse arsyetimi i tyre nga ana e AK (pa nevojë që të përsëriten të gjitha serish) nuk është i mjaftueshëm për bindjen dhe gjykimin e pavarur të këtij Paneli, sipas të cilit rivlerësimi i aktivitetit të prokurimit në rastin konkret nënkupton zgjidhjen e duhur dhe vendimin më të dejtë për tu përmbushur kërkesat e LPP, sipas të cilit kërkohet që prokurimi publik të manifestoj integritetin e procesit të prokurimit, përgjegjësinë dhe kulturën institucionale dhe profesionale (neni 1). Paneli vëren se vërtet A testet nuk kanë qenë pjesë e DT, mirëpo të njëjtat gjatë rrjedhjes së aktiviteti janë kërkuar nga AK përmes sqarime të tij/saj të datës 28.09.2022 dhe të njëjtat pa dashje janë shndërruar në kriter dhe/ose kërkesa të AK përkitazi me produktin dhe/ose cilësitë e tij. Për shembull në përgjigje e cituar si më sipër thuhet: cituar:

- “dëshmitë e kërkuara nga ne si AK duhet të jenë nga laborator të akredituar. Se çka duhet të përmbajë testimi është e specifikuar...” “A testet e kërkuara duhet të jenë nga laboratorët e akredituar ndërkombëtar sipas EN ISO standardit të kërkuar në tërësi si produkt final”
- “...në secilin rast duhet të dëshmohet me A test laboratorik se çizmet e ofruara janë testuar në tërësi dhe kanë kaluar A testet konform EN ISO 2047: 2021”
- “...përderisa certifikata vjen nga laborator i akredituar dhe ka validitetin dhe i plotëson kërkesat e dëshmimeve të kualitetit, lejohet”.
- “secili produkt i cili është certifikuar nga laboratorët e njohura botërore me ISO standarde do të jenë pjesë e vlerësimit”
- “A testet ose certifikata e lëshuara vetëm për inspektim vizual dhe/ose që nuk kanë akreditimin përkatës nuk do të jenë të pranueshme për vlerësim”

Prandaj në kontekstin e përgjithshëm të administrimit të provave, Paneli konsideron se rekomandimet e ekspertit shqyrtues gjejnë vend për mbështetjen e tyre në trajtimin e këtyre pohimeve ankimore, sepse AK është dashur që me rastin e planifikimit të prokurimit dhe përpilimit të kriterëve në DT të udhëhiqet me kujdesin e duhur dhe profesional sepse çdo sqarim i cituar si më sipër, sipas Përgjigjes së cituar, nënkupton ambiguitet (dykuptimësi) të cilat mund të përdoren në varësi të kontekstit. Prandaj Paneli konsideron se AK gjatë këtij aktiviteti nuk ka vepruar në harmoni me dispozitat ligjore të LPP dhe kërkon nga AK që në procesin e rivlerësimit të ketë në konsideratë shpjegimet e dhëna më sipër, në të kundërtën OSHP ka autoritetin e plotë dhe kompetencat që ta inicioj procedurën për ndërmarrjen e masave përkatëse.

Pas shqyrtimit të gjithmbarshëm të shkresave të lëndës, përmbajtjes së pohimeve ankimore të ankuesit OE RUNWAY, Paneli shqyrtues, konsideron se çështje kyçe e cila ka ndikuar në marrjen e vendimit si në pikën 2 të dispozitivit, konsiston në faktin se ankuesi në këtë rast, nuk ka argumentuar se klasifikohet si pale me interes në këtë aktivitet të prokurimit, për shkakun parimor se në ankesën e tij nuk e ka atakuar pretendimin e OE ofertues i renditur i dyti me radhë për nga çmimi, përderisa ankuesi respektivisht OE RUNWAY, nga cilësia e tij si ofertues është radhitur i treti, pas ofertës së OE “SOLID ShPK” e cila është radhitur e dyta duke ju referuar çmimit më të lire (255.000 €) në bazë të vendimit të AK. Lidhur me këtë, Paneli konstaton se OE ankues në këtë rast nuk ka ofruar asnjë dëshmi, argument, arsye apo pretendim se oferta e “SOLID ShPK” mund të cilësohet si e papërgjegjshme dhe objektivisht rezulton se OE ankues në këtë rast nuk ka dëshmuar se ka statusin e palës me interes në kuptim nenit 4 të LPP sipas të cilit shprehimisht parashihet se, cituar: *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit...”*. Andaj duke u bazuar në shpjegimet si më sipër, Paneli konstaton se nuk ka bazë që kjo ankesë të përfshihet në shqyrtimin e pretendimeve ankimore, për faktin se ankuesi nuk ka përfillur kriteret procedural që parashihen me legjislacionin në fuqi dhe njoftimit të publikuar andaj dhe vendosi sikurse në dispozitiv.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, *“Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”*. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga *palët e interesuara* duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

*- Përfundim -*

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vlerëson se aktiviteti i prokurimit duhet të rivlerësohet në mënyrë që ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i aktivitetit të prokurimit të bëhet konform nenit 59 të LPP-së. Po ashtu palët e interesuara duhet të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e aktiviteteve të prokurimit. Paneli shqyrtues thekson se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të respektojnë dispozitat e LPP-së dhe të veprojnë konform qëllimit të këtij ligji.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, kurse lidhur me kthimin e tarifës ankimore është vendosur konform nenit 31 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues  
Vjosa Gradinaj Mexhuani



**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- AK-Ministria e Mbrojtjes
- Ankuesve
- Arkivës së OSHP
- Për publikim në ueb-faqe